

|                                                                                   |                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                        |                               |                            |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|-------------------------------|----------------------------|
|  | <b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b><br>REPUBLIKA KOSOVA<br>REPUBLIC OF KOSOVA<br><b>KOMUNA –SUHAREKË</b><br>OPSTINE SUVA REKA | 10.07.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                        |                               |                            |
|                                                                                   |                                                                                                                      | <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div>  </div> <div> <b>REPUBLIKA E SUHAREKËS</b><br/>         REPUBLIKA SUVA REKA<br/>         MUNICIPALITY OF SUHAREKA       </div> <div>  </div> </div> |                        |                               |                            |
|                                                                                   |                                                                                                                      | <b>MARRË NË DORË / PRILJENO-RECEIVED</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                        |                               |                            |
|                                                                                   |                                                                                                                      | Njësia Org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Num.<br>Broj<br>Number | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
|                                                                                   |                                                                                                                      | 01                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 016                    | 31912                         | 7                          |

|       |                                                                                                                                                   |                                   |
|-------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|
| 11.Nr | <b>Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhëniein për shfrytëzim afatshkurter të pronës së palujtshme të Komunës</b> | <b>Datë:</b><br><b>10.07.2026</b> |
|-------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|

Në bazë të Vendimit Nr.016/13484, të datës 26.03.2026, të Kuvendit Komunal, si dhe në bazë të Vendimit për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave Nr.01/410/24513 të datës 29.05.2026, sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për dhëniein në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, komisioni përkatës shpall:

### ANKAND PUBLIK Nr. 02/2026

**Për dhëniein në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme**

Lokali afarist O-72116046-43-1-3-0, me sipërfaqe të përgjithshme  $S = 54m^2$ , sipas certifikatës së pronës Nr. 11-463-1-3-0, datë 06.03.2026, në zonën kadastrale **Suharekë**, e evidentuar si pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

#### Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për person fizik / juridik.
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit (për personat juridikë).
3. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (për personat juridik - fizik)
4. Deklarata nën betim për vizitën e lokaleve afariste, (kam hyrë brenda, apo e kam parë nga jashtë të lajmrohet në sportelin nr.1)
5. Oferta e kompletuar, një zarf Originali dhe një zarf tjetër Kopja, në një zarf tjetër të vendoset kopja dhe origjinali dhe jashtë zarfit të shënohen të dhënat e aplikuesit dhe të dhënat e ankandit. (Kjo dëshmi kërkohet në përputhje me rekomandimet e komisionit të ankesave).
6. Dëshmi për mos falimentimin e biznesit e nxjerrur nga Gjykata Komerciale

#### Kriteret e kërkuara:

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara: (Një original dhe një kopje)
- Çmimi fillestar për m<sup>2</sup> të parcelës (referuar rregullores së Komunës – 5€/**m2** në muaj) vlerësohet / me **60 pikë** 60%
- Projekti ideor konceptual lidhur me zhvillimin e aktivitetit afarist banesor vlerësohet / me **20 pikë** 20%
- Numri i punëtorëve dhe plani dinamik 12 muaj lidhur me zhvillimin e aktivitetit biznesor vlerësohet me **20 pikë**. (ky vlerësim vlen deri në 5 punëtorë, mbi 5 punëtorë vlerësimi sërish do të mbetet 20 pikë 20%)

#### Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve nënkupton diskualifikim.
- Veprimtaria jo adekuate (referoju planifikimit hapsinor për atë zonë) do të diskualifikohet nga ankandi
- OE ka të drejtë të tërhiqet nga ankandi publik jo më vonë se 3 (tre) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- Rekomandohet që aplikuesit të vizitojnë lokalet para mbylljes së ofertës dhe të njihet me gjendjen ekzistuese.
- Të gjithë të interesuarit për aplikim në këtë ankand public dhe të interesurit për vizitë të lokaleve që janë pjesë e këtij ankandi duhet të drejtohen tek zyret e Drejtorisë së Pronës dhe Kadastrit.
- Oferta duhet të dorëzohet në dy ekzemplarë: një original dhe një kopje, të mbyllura në zarf.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë **30.07.2026**, në zyrën pritëse të Gjendjes Civile, Komuna e Suharekës.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më **datë 30.07.2026**, deri në **ora 13:30**, në zyrën pritëse të Gjendjes Civile, Komuna e Suharekës. Oferta duhet të jetë e protokolluar.

Hapja e ofertave bëhet më datë **30.07.2026**, në **ora 15:00**, në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Informata shtesë:

Nr. tel.: 029 271 708

Mob.: 049 838 387

Email: Mensur.selimaj@rks-gov.net

